



TrafikuUrban
PRISHTINË

NDËRMARRJA PUBLIKE KOMUNALE
MUNICIPALITY PUBLIC ENTERPRISE
"TRAFIKU URBAN" SH.A.
PRISHTINË

№ 877 dt. 12.03 2024

N.P.K. "TRAFIKU URBAN" SH.A.

RAPORTI VJETOR 2023



Prishtinë, 2024

RAPORTI VJETOR PËR AKTIVITETET E
N.P.K. TRAFIKU URBAN SH.A. PËR VITIN 2023

Bordi i Drejtorëve të N.P.K. "Trafiku Urban" SH.A. miratoi Raportin Vjetor për vitin 2023 me nr. 877 i dt. 12.03.2024 në mbledhjen e mbajtur me datë: 12.03.2024.

	Delegoi	Aprovoi
Emri Mbiemri:	Burim Maraj, Kryeshef Ekzekutiv	Ylber Çitaku, Kryesues i Bordit të Drejtorëve
Nënshkrimi:		
Data:	12.03.2024	12/03/2024



Përmbajtja

N.P.K. "TRAFIKU URBAN" SH.A.	0
RAPORTI VJETOR 2023	0
Shkurtesat	4
I. HYRJE	5
Pasqyra e strukturës organizative të ndërmarrjes me të gjitha ndryshimet gjatë vitit 2023	6
II. PROFIL I SHKURTËR PËR NDËRMARRJEN.....	7
I. RAPORTI I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE	8
II. RAPORT I KRYESHEFIT EKZEKUTIV	11
Efikasiteti Operacional dhe Zgjerimi i Flotës:	11
Mirëqenia dhe Nisma Shëndetësore për Punonjësit:.....	11
Forma e re e pagesës së biletës:.....	11
Avancimet Teknologjike:.....	11
Njohje dhe Vlerësim:.....	12
Aksesibiliteti dhe Përfshirja:	12
Rritja e Numrit të Udhëtarëve dhe Zgjerimi i Tregut:.....	12
Performanca Financiare me Shifra Historike:	12
III. ZYRA E KRYESHEFIT	13
Çertifikimi i pagesave	13
Siguria dhe shëndeti në punë	13
Rekomandimet të ndryshme	14
Shenjzimet	15
Informimi	16
Përcjellja e aktiviteteve dhe hartimi i komunikatave	16
Qasja në dokumente publike	16
Njësia e kontrollës së brendëshme.....	16
IV. SEKRETARI.....	18
Takimet e Bordit të Drejtorëve	18
V. DREJTORIA E PROKURIMIT	19
Kontratat/transaksionet 2023	19
VI. DREJTORIA E FINANCAVE.....	20

Performanca financiare e N.P.K “Trafiku Urban” sh.a për periudhën 2019-2023.....	20
VII. DREJTORIA E ADMINISTRATËS	24
Zyra Ligjore.....	24
Zyra e Burimeve Njerëzore	29
Avancimi i vazhdueshëm profesional i punëtorëve.....	40
Marketingu.....	40
VIII. DREJTORIA E OPERATIVËS.....	41
Sektori i Transportit	43
Sektori i Mirëmbajtjes.....	48
Sektori i shërbimeve mbështetëse	52
IX. Shtojca 1:	53
Pasqyrat Financiare të Ndërmarrjes	53
Shpalosjet.....	56
X. Shtojca 2: Drejtoria e Prokurimit – kontratat/transaksionet 2023	64

Shkurtesat

Lista e shkurtesave	
TU	Trafiku Urban
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
KSHP	Kontrata për Shërbim Publike
KSHP (PSC)	Kontrata për Shërbim Publik (Public Service Contract)
BD	Bordi i Drejtorëve
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
KE	Kryeshefi Ekzekutiv
ZAB	Zyrtari për Auditim të Brendshëm
ZKFTH	Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit
PF	Pasqyrat Financiare
PA	Pasqyra e te Ardhurave
PSH	Pasqyra e Shpenzimeve
LLP	Llogari e Pagueshme
LLA	Llogari e Arkëtueshme
IKSHP	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike
ARBK	Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë
LPP	Ligji i Prokurimit Publik

I. HYRJE

Raporti Vjetor i Ndërmarrjes Publike "Trafiku Urban" për vitin 2023 është hartuar në përputhje me Nenin 31 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike. Ky raport jep një pasqyrë të detajuar të suksesit të ndërmarrjes, duke shënuar vitin më të suksesshëm në historinë e saj.

Gjatë vitit 2023, menaxhmenti i ndërmarrjes ka arritur të realizojë me sukses objektivat kryesore, në fokus përmirësimin e kushteve të punës dhe mirëqenies së punonjësve me qëllim të avancimit të përgjithshëm të shërbimeve për komunitetin tonë.

Përmirësimet përfshijnë sigurimin e trajtimit të barabartë për punonjësit, ofrimin e sigurimit shëndetësor, paga jubilarë, rritje të pagës në mënyrë lineare, si dhe shumë avansime tjera që kanë ndikuar drejtpërdrejt në staf më të motivuar, rrjedhimisht në shërbime më të mira ndaj shfrytëzuesve të shërbimeve të transportit publik.

Përveç kësaj, viti 2023 ishte vit i promovimit të shërbimeve tona përmes platformave, ofertave dhe iniciativave të ndryshme, duke e bërë kështu ndërmarrjen dhe shërbimet që ofrojmë më atraktive dhe me impakt të jashtëzakonshëm në rritje të numrit të udhëtarëve.

Plani vjetor i punës për vitin 2023 i Ndërmarrjes Publike "Trafiku Urban" është zbatuar me duke u bazuar në objektivat e përcaktuara nga departamentet dhe njësitë përkatëse, përfshirë prioritetet strategjike. Aktiviteti kryesor i ndërmarrjes vazhdon të jetë transporti i udhëtarëve përkatësisht ofrimi i shërbimit të transportit publik në Komunën e Prishtinës përmes 51 autobusëve që posedon ndërmarrja. Raporti vjetor përfshin analiza të thelluara mbi aktivitetin financiar, të ardhurat dhe shpenzimet, operativën, punësimin, investimet dhe informacione tjera të rëndësishme lidhur me Trafikun Urban.


Viti 2023 do të mbetet vit i shënuar për Ndërmarrjen Publike "Trafiku Urban", si viti më i suksesshëm deri më tani, si nga numri i udhëtarëve ashtu edhe nga bilanci financiar. Ndërmarrja "Trafiku Urban" ka shënuar një rritje të shifrave të udhëtarëve, duke regjistruar një numër rekord prej 35,000 udhëtarësh në ditë ose mbi 12 milionë udhëtarëve në vit. Të hyrat e realizuara në vitin 2023 janë 9.063,608, krahasuar me vitin 2022 janë të hyra 23.61% më të larta dhe me një Fitim Neto prej 310.26% më të lartë nga viti paraprak.

Numri prej më shumë se 12 milionë udhëtarëve dëshmon besimin që komuniteti ka te shërbimet tona të transportit publik. Kjo arritje do të jetë një frymëzim i rëndësishëm për të vazhduar me përpjekjet dhe përmirësimet edhe në të ardhmen, duke ruajtur një standard të lartë të shërbimit dhe kontribuar në përmirësimin e jetës së qytetarëve të Prishtinës.

Pasqyra e strukturës organizative të ndërmarrjes me të gjitha ndryshimet gjatë vitit 2023

Ndërmarrja udhëhiqet sipas hierarkisë konform Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087.

- Komisioni Komunal i Aksionarëve,
- Bordi i Drejtorëve,
- Zyrtarët e lartë (Kryeshefi Ekzekutiv, ZKFTH, Sekretari i Ndërmarrjes dhe ZAB),



II. PROFIL I SHKURTËR PËR NDËRMARRJEN

N.P.K. "Trafiku Urban" SH.A. në Prishtinë ushtron veprimtarinë e transportit të udhëtarëve në linjat urbane dhe urbane-periferike me qëllim të organizimit të jetës dhe punës së qytetarëve dhe hyn në rangun e veprimtarive tjera shërbyese komunale. Për shkak të rëndësisë që ka ky shërbim i veçantë, ka filluar të kryhet në mënyrë të organizuar nga Komuna e Prishtinës që nga dt. 01.04.1976 kur ndërmarrja "Trafiku Urban" u themelua si Ndërmarrje Publike Komunale (N.P.K. "Trafiku Urban" SH.A.). Ky organizim është ndërmarrë me qëllim që qytetarëve t'u ofrohet transport i organizuar, i cili ndikon në siguri dhe zvogëlim të dendësisë së trafikut në rrugët e qytetit.

Pas luftës çlirimtare, në vitin 1999 ndërmarrja është regjistruar si subjekt afarist pranë administratës së përkohshme të OKB-së me dt. 22.06.2000 nën numrin e regj. 80060459 dhe është ri - regjistruar me dt. 22.06.2004 pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë të Kosovës me nr. e regj. të biznesit: 70163585 dhe nr. Unik identifikues 811289009, nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK).

Bazuar në ligjin për NP me NR 03/L-087 dhe Ligji Nr. 04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit NR. 03/L-087, për NP, dhe Ligjin Nr. 05/L -009 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit NR. 03/L-087, për NP. NPK "Trafiku Urban" SHA është regjistruar si Ndërmarrje Publike Komunale SH.A. në Prishtinë.

NR.	EMRI I NDËRMARRJES	NDËRMARRJA PUBLIKE KOMUNALE "TRAFIKU URBAN" SHA PRISHTINË
1.	Adresa	Rr. Tahir Zajmi nr. 43, 10 000 Prishtinë
2.	Themelimi	01.04.1976 – Prishtinë, me ndryshim dhe plotësim të Ligjit nr.04/L-111 është emërtuar si Ndërmarrje Publike Lokale.
3.	Themelues	Kuvendi Komunal i Prishtinës
4.	Prona	Pronë Publike Komunale
5.	Veprimtaria primare	Transporti rrugor urban dhe ndërurban i pasagjerëve
6.	Veprimtaria sekondare	Transporti tjetër rrugor i pasagjerëve p.k.t.
7.	Aktivitete tjera	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve Tregtia me shumicë e lëndëve djegëse të ngurta, të lëngëta ose të gazta dhe produkteve të lidhur me to
8.	Të punësuar	Ndërmarrja ka të punësuar 408 punëtorë të rregullt.
9.	Pasuria	Pasuria e patundshme është në proces të definimit të titullarit, ndërsa pasuria e luajtshme e ndërmarrjes përbëhet nga 51 autobusë urban, vetura, vegla, pajisje dhe makinat të punës për mekanikë.
10.	Menaxhimi	Ndërmarrja menaxhohet nga Kryeshefja Ekzekutive, Bordi i Drejtorëve dhe mbikëqyret nga Komisioni Komunal i Aksionarëve.
11.	Regjistrimi	Ndërmarrja mban regjistrimin e biznesit pranë MTI së Kosovës nr. regj. Biz. 70163585 dhe nr. Unik Identifikues: 811289009

I. RAPORTI I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE

Raporti vjetor për vitin 2023, është një përmbledhje e punës për vitin kalendarik 2023.

Ky raport është përpiluar në përputhje me dispozitat e nenit 31 paragrafi 31.3 të Ligji Nr.03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike dhe nenin 18 të Ligji Nr. 04/L-111 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike.

Pasi që Zyrtarët e NP-së, kanë përgatitur dhe dorëzuar raportin, Bordi i Drejtorëve ka shqyrtuar, plotësuar në raste edhe ndryshuar dhe miratuar raportin në fjalë. Qëllimi i këtij raporti është që ti sigurojmë Komisionin Komunal të Aksionarëve, Kryetarin e Komunës, anëtarët e asamblesë Komunale dhe palët e interesuara me informatat në lidhje me performancën operationale dhe financiare të N.P.K. "Trafiku Urban" Sh. A. Prishtinë,

Po kështu, Raporti ynë vjetor i ofron klientëve tanë dhe komunitetit informacione në lidhje me ndërmarrjen tonë, si dhe një pasqyrë të performancës sonë në fushat kryesore të biznesit, mbi veprimet e marra, rezultatet financiare të arritura, mbi projektet e realizuara, efektiviteti dhe efikasiteti i përgjithshëm në raport me objektivat e vendosura në Planin e Biznesit për Vitin 2023 si dhe sfidat dhe çfarë po bëjmë për përballjen e tyre, pra, gjatë vitit 2023, Ndërmarrja Publike Komunale "Trafiku Urban" Sh.A. Prishtinë, përveç që ka operuar me sukses, duke u bërë një ndër ndërmarrjet publike shembull, ka hasur edhe në probleme të ndryshme, që janë sfida nëpër të cilat Ndërmarrjet e tilla herëpashere kalojnë.

Gjatë vitit 2023, Bordi i Drejtorëve ka zgjedhur Kryeshefin Ekzekutiv, i cili me vendim zyrtar ka marrë detyrën e KE me datën 03.04.2023. Aksionarët e Ndërmarrjes e kanë parë të arsyeshme që të ndryshojnë përbërjen e Bordit të Drejtorëve (edhe për faktin se BD ishte me mandat të përkohshëm), rrjedhimisht kan filluar me procedurat për të rekrutuar përbërjen e re të BD, andaj në fund të vitit 2023 kan përfunduar procedurat e rekrutimit, rrjedhimisht është zgjedhur përbërja e re jo complete e BD. Ky raport trajtohet dhe Miratohet nga përbërja e re e Bordit të Drejtorëve të cilët faktikisht këtë obligim e kryejn pasi që rrethanat / afatet ligjore janë të tilla, edhe pse në fakt gjatë vitit 2023 nuk kanë pas asnjë përgjegjësi a obligim ligjor për Ndërmarrjen, gjithsesi kjo nuk do të thot se përbërja e tanishme e BD e ka trajtuar këtë raport sa për të kryer obligimin, përkundrazi, janë mbajtur takime konsultative me Zyrtarët e Lartë, janë shkëmby materjale, dokumente e informacione, madje BD ka mbajtur takim pune (pranim dorzimi i mandatit) dhe shkëmbim informacionesh e materjale, nga BD nga mandati i kaluar të cilët na kanë njoftuar për sfidat, vështërsit po edhe për sukseset dhe të arriturat.

Gjatë vitit 2023 është krijuar një ambient bashkëpunues pune, duke vë në fokus të veçantë operimet e ndërmarrjes dhe mbarëvajtjen e proceseve në tërësi. Gjatë kësaj kohe, në vazhdimësi është tentuar që Bordi i Drejtorëve, përfshirë Komitetin e Auditimit të jetë proaktiv dhe të ketë informacione të mjaftueshme për të marrë vendimet. Janë aprovuar me rregull raportet, Raporti vjetor i vitit 2022 dhe

raportet tremujore të vitit 2023, ndërsa gjatë shqyrtimit të mundësive për përmbushjen e synimeve strategjike për përmirësim të performancës janë detektuar edhe disa indikatorë të ri.

Gjatë vitit 2023, objektivi për të rritur pasurinë e Ndërmarrjes është paraqitur si sfidë e cila ka involvuar disa akterë, këta akterë sfidat e reja administrative e ligjore po punojnë bashkarisht që ti përballojnë me sa më shumë sukses, andaj Bordi i Drejtorëve e ka parë të nevojshme që të jetë i informuar gjatë gjithë kohës.

Numri në rritje i kërkesave për përdorim / shfrytëzim të transportit publik nga qytetarët e Prishtinës, tregon për cilësinë e shërbimeve dhe imazhin e mirë që ndërmarrja po krijon nga dita në ditë. Poashtu, besimi që Kryetari i Komunës i ka dhënë Ndërmarrjes me nënshkrimin e Aneks marrëveshjes për rritje të çmimit për kilometër dhe Indikatorëve të Performancës (Diesel and KPI Update) nr.3565 dt.26.09.2023, tregon që ndërmarrja është në rrugë të mbarë të arritjes së objektivave strategjike për të zgjeruar llojin e shërbimeve që ofron, duke qenë profitabile dhe njëkohësisht në shërbim të qytetarëve dhe Kryeqytetit.

Sugjerime dhe propozime nga BD për rritjen e performancës

Bazuar në efektivitetin dhe efikasitetin e punëve të kryera, një prej sfidave të ndërmarrjes mbetet mosha e vjetër e punëtorëve dhe kapacitetet profesionale që ngecin në raport me trendin dhe dinamikën e zhvillimeve globale. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional (EVP) i stafit është një funksion shumë strategjik dhe organizativ, çelës për rritjen e performancës dhe reformimin e vazhdueshëm të Ndërmarrjes me synim të rritjes së stabilitetit dhe të përshtatjes / adoptimit me kërkesat e kohës.

Me qëllim të rritjes së performancës së punës të N.P.K. "Trafiku Urban" Sh. A. Prishtinë, sugjerimet e Bordit të Drejtorëve për menaxhmentin e ndërmarrjes për periudhën vijuese listohen si në vijim:

- Të ketë koordinim dhe bashkëpunim të plotë dhe të vazhdueshëm në mes menaxhmentit dhe Bordit të Drejtorëve, BD me Komisionin Komunal të Aksionarëve me qëllim të harmonizimit të politikave zhvillimore të ndërmarrjes.
- Vazhdim i ngritjes së nivelit të marrëdhënieve të mira me klientët- udhëtarët, operatorët tjerë ekonomik përmes shërbimeve cilësore veprime këto që do të ndikojnë në rritjen e besueshmërisë reciproke.
- Zhvillimi i mëtejshëm i digjitalizimit të N.P.K. "Trafiku Urban" Sh. A. Prishtinë
- Funksionalizimi i Sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të punëve për të gjithë punëtorët e ndërmarrjes.
- Hartimi i politikave të zhvillimit profesional dhe mekanizmave stimules, menaxhimi i performancës.
- Ngritja e kapaciteteve matëse të përgjegjësisë / llogaridhënies në aspektin e efektivitetit dhe efikasitetit të punëve të kryera dhe të besueshmërisë institucionale.

Raporti i punës për vitin 2023 përmban dhe pasqyron në mënyrë të detajuar dhe profesioanle elementet në vijim:

- Organogramin,
- Përshkrim të fushveprimtarisë së NPK "Trafiku Urban" Sh. A. Prishtinë,
- Aktet nënligjore,
- Pasqyrat financiare,
- Operimet / shërbimet,
- Partnerët dhe bashkëpunëtorët,
- Projektet e implementuara,
- Ndryshimet kadrovike,
- Rekomandimet nga BD

II. RAPORT I KRYESHEFIT EKZEKUTIV

Jam i lumtur të prezantoj Raportin Vjetor të Trafikut Urban për vitin 2023, një pasqyrë gjithëpërfshirëse që përshkron angazhimin tonë të pandërprerë për vizionin tonë themelor: ofrimin e një shërbimi më të mirë, përmirësimin e kushteve të punës dhe avancimin e performancës në përgjithësi.

Duke reflektuar mbi arritjet e theksuara në raport, është e rëndësishme të njohim përkushtimin dhe angazhimin e tërë punëtorëve të Trafikut Urban, si pjesë vitale në arritjen e sukseseve të ndërmarrjes. Objektivat strategjike të vendosura nga ekipi menaxhues kanë qenë pikënisje e një progresi të vazhdueshëm gjatë vitit 2023. Sukseset dhe arritjet e ndërmarrjes do të paraqiten përmes shifrave dhe grafeve të ndyshme përgjatë raportit. Duke qenë një vit me suksese kulminante, duke e përshkruar vitin më të suksesshëm në historikun e ndërmarrjes po i paraqes në pika të shkurtra disa nga këto arritje;

Efikasiteti Operacional dhe Zgjerimi i Flotës:

Vendimi për të blerë 30 autobusë të rinj, përfshirë 6 autobusë elektrikë, do të përmirëson shërbimin tonë duke shtuar konsiderueshëm kapacitetin tonë operacional. Flota e zgjeruar jo vetëm që do të përmirëson besueshmërinë e shërbimit, por është e harmonizuar edhe me angazhimin tonë për zgjidhje të qëndrueshme dhe miqësore ndaj mjedisit.

Mirëqenia dhe Nisma Shëndetësore për Punonjësit:

Nisja e mbulimit të sigurimit shëndetësor për të gjithë punonjësit thekson përkushtimin tonë ndaj mirëqenies së tyre. Forca jonë punëtoare është struktura kryesore e suksesit tonë, andaj synjmë të krijojmë një mjedis që i kushton rëndësi shëndetit dhe sigurisë së tyre. Kjo nismë jo vetëm kontribon në një staf më të shëndetshëm dhe më të motivuar, por gjithashtu reflekton pozitivisht mbi përgjegjësinë tonë shoqërore korporative.

Forma e re e pagesës së biletës:

Ofrimi i mundësisë së pagesës së biletës përmes SMS ka lehtësuar procesin e blerjes së biletave, duke ofruar udhëtarëve një alternativë të re dhe efikase. Kjo formë e re për pagesat jo vetëm përmirëson eksperiencën e klientit, por gjithashtu përputhet me përkushtimin tonë për të qëndruar në krye të avancimeve teknologjike në industrinë e transportit, si hap para digjitalizimit të plotë të këtyre shërbimeve.

Avancimet Teknologjike:

Implementimi i E-i-Fi falas në autobusët tanë jo vetëm shërben si një mjet promovues, por gjithashtu reflekton përkushtimin tonë për pranimin e avancimeve teknologjike në dobi të udhëtarëve tanë. Kjo shtesë jo vetëm ka përmirësuar eksperiencën e përgjithshme të udhëtarëve, por na pozicionon si një shërbim transporti i orientuar nga klienti dhe i orientuar nga teknologjia.

Njohje dhe Vlerësim:

Vendimi për njohjen e pagesave jubilarë për punonjësit që kanë arritur periudhën jubilarë reflekton mirënjohjen tonë për përpjekjet dhe kontributin e tyre të gjatë në ndërmarrje. Është e rëndësishme njohja e jubileut për anëtarët e ekipit tonë, pasi kontributi i tyre është i domosdoshmëm për suksesin tonë të përbashkët. Po ashtu gjatë vitit 2023 është rritur vlera e shujtës ditore për të gjithë punëtorët e ndërmarrjes.

Aksesibiliteti dhe Përfshirja:

Investimi në shërbime dhe infrastrukturë më të mira për individët me aftësi të kufizuara ka qenë një bazë e përkujdesjes sonë për furnizimin e një transporti të përfshirë. Kemi implementuar përmisim infrastrukturë në hapësirat e ndërmarrjes dhe në autobusë, në hapësira të dedikuara për të siguruar një eksperiencë udhëtimi pa pengesa për të gjithë udhëtarët me aftësi të kufizuara. Përmisimi i infrastrukturës do të përfundon më instalimin e sistemit informues me zë dhe video në autobusë gjatë vitit 2024.

Rritja e Numrit të Udhëtarëve dhe Zgjerimi i Tregut:

Rritja e konsiderueshme e numrit të udhëtarëve në bazë ditore, duke arritur një shifër rekord prej 35,000 udhëtarësh në ditë ose mbi 12 milionë në vit, është një dëshmi e efektshmërisë së strategjive tona të marketingut dhe rritjes së cilësisë së shërbimit. Ne po eksplorojmë aktivisht mundësitë për zgjerim të tregut dhe shpërndarje të reja për të përmbushur kërkesën rritëse për shërbimet tona.

Performanca Financiare me Shifra Historike:

Ky vit shënon një fazë vendimtare për Ndërmarrjen Publike "Trafiku Urban", duke e bërë vitin më të suksesshëm dhe duke e konfirmuar transportin publik si një mjet i alternativ transporti në të mirë të përgjithëshme të qytetarëve dhe ambientit ku jetojmë. Të hyrat e vitit 2023 shënojnë një shifër prej 9.063,608 euro, një rritje prej 23.61% në krahasim me vitin 2022.

Në përfundim, ky vit ka qenë një kapitull i suksesshëm, por sfidat dhe synimet tona vazhdojnë. Jemi të vendosur të vazhdojmë rrugën drejt përmirësimit të shërbimit, inovacionit dhe arritjes së qëllimeve tona të mëdha. Faleminderit për kontributin dhe përkushtimin tuaj në ndërmarrjen tonë.

Burim Maraj

Kryeshef Ekzekutiv

III. ZYRA E KRYESHEFIT

Çertifikimi i pagesave

Bazuar në planifikimin dhe dinamiken e punës gjatë vitit 2023 janë certifikuar realizimet e shpenzimeve buxhetore përmes prokurimit të N.P.K. "TRAFIKU URBAN" SH. A.

Para autorizimit të pagesave sipas kontratës publike jemi siguruar që kushtet e zbatueshmërisë janë përmbushur dhe me qëllim të transparencës në shpenzimin e parasë publike ku rrjedhimisht certifikimi i lëndëve është në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe konform rregulloreve të brendshme.

Certifikimi i lëndëve nënkupton që llogaridhënia e projekt menaxherëve është më e madhe, shpenzimet përmes prokurimit janë të kontrolluara dhe mbahet evidencë më kuptimplote e aktiviteteve.

Gjithashtu me qëllim të rritjes së transparencës nga muaji Dhjetor 2023 kemi filluar me procedurën e certifikimit të parasë se imët (Petty Cash).

Raporti i lëndëve të certifikuara është përmbledhur në formë tabelare në vazhdim

Nr. rendor	Llojet e procedurave të certifikimit	Numri total i lëndëve të certifikuara gjatë vitit 2023
1	Certifikimi përmes Prokurimit	185 lëndë
2	Certifikimi me Petty Cash	16 lëndë
3	Kontratë jashtë procedurave të prokurimit	2 lëndë

Siguria dhe shëndeti në punë

Trafiku Urban është i angazhuar në zhvillimin dhe mbajtjen e një kulture të menaxhimit pro aktiv të shëndetit dhe sigurisë në punë.

Qëllimi është që të identifikohen kërcënimet e mundshme ndaj sigurisë dhe shëndetit të punësuarve dhe personave të tjerë, objekteve, pajisjeve të ndryshme duke identifikuar rreziqet dhe klasifikuar prioritetet në të cilat kanë qenë më të nevojshme (urgjente) të intervenohet.

Rekomandimet të ndryshme

Gjatë kësaj kohe janë dhënë gjithsej 11 (njëmbëdhjet) rekomandime të ndryshme, të cilat janë realizuar me sukses.

REKOMANDIM	DATA
Raport mbi servisimin e aparateve për shuarjen e zjarrit	07/01/2023
Rekomandim për mirëmbajtjen e hapësirës së trafikut urban nga ngricat rrëshqitja	03/02/2023
Rekomandim për shtrimi e një traseje me zhavorr	12/04/2023
Hapësira e lejuar për pirjen e duhanit	28.04.2023
Rekomandim për kontrollë sistematike të aparateve për fikjen e zjarrit	30.09.2023
Rekomandim të themelohet komisioni për kontrollimin në mënyrë sistematike të gjitha aparatet për fikjen e zjarrit	03/05/2023
Rekomandim për përmirësimin e kushteve të punës në zyrën evidencës së orëve të punës, zyra nr. 10	18/07/2023
Rekomandim për furnizim me material të kutive të ndihmës së parë	06/09/2023
Rekomandim për kontrollë sistematike të të gjitha instalimeve elektrike në ndërmarrje	20/11/2023
Rekomandim për mirëmbajtjen e hapësirës së trafikut urban nga ngricat/rrëshqitja	27/11/2023

Shenjëzimet

Në fazën e parë janë vendosur: pajisje, shenja obligative dhe informuese gjithsej 140 prej tyre.

LLOJET E SHENJËZIMEVE	SASIA
Njoftime të "Numrave Emergjent"	18
Shenja të "Hidrantëve kundër zjarrit"	10
Shenja të "Aparateve Kundër Zjarrit"	22
Shenja të "Rrugës së lejuar për ecje"	25
Shenja "Njoftim për punonjësit e Trafikut Urban"	10
Shenja të "Pajisjeve obligative të sigurisë në vendpunishte"	6
Shenja të "Rreziqeve dhe dëmtimeve në zyre të administratës"	10
Shenjë "Pajisjet obligative gjatë punës në auto-larje"	1
Shenja të "Pajisjeve obligative të sigurisë gjatë punës"	6
Shenja "Kujdes tension i lartë"	5
Shenja "Substanca lehtë të ndezshme"	2
Shenja "Substanca helmuese kimike"	2
Shenja "Ndalimi i duhanit"	3
Shenja "Hapësira nën vëzhgim të kamerave"	3
Shenja " Orari zyrtar i administratës"	2
Shenja "Pjesët përbërëse të bombolës kundër zjarrit"	15

Informimi

Komunikimi i institucioneve me qytetarët, është pjesë qenësore e veprimtarisë së përditshme. Përgjegjësia publike mbi institucionet komunale nuk mund të ushtrohet pa njohuri të mjaftueshme për punën që bëhet brenda atyre institucioneve.

Në këtë frymë, Komunikimi / informimi për aktivitetet e Trafikut Urban kanë qenë Komunikime personale, grupe dhe masive, gjithnjë me transparencë për qytetarët, mediat dhe shoqërinë civile.

Përcjellja e aktiviteteve dhe hartimi i komunikatave

Zyra për informim ka ndjekur të gjitha aktivitetet dhe takimet e paralajmëruara të Ndërmarrjes dhe Kryeshefit Ekzekutiv, ka hartuar informacionet (komunikatat) për to, i ka postuar në ueb-faqe të Trafikut Urban dhe ua ka dërguar ato mediave.

Po ashtu është përgjigjur në pyetjet e gazetarëve dhe në ankesat e përditshme të qytetarëve që kanë arritur në email-n zyrtarë info@trafikurban-pr.com dhe në faqen zyrtare të Facebook-ut të Trafikut Urban.

Qytetarët janë njoftuar paraprakisht dhe me kohë për ndryshimet eventuale në linjat e autobusëve si pasojë e punimeve nëpër rrugët e Kryeqytetit dhe po ashtu janë dhënë sqarimet përkatëse për çdo rast të ndodhur gjatë punës në trafik.

Qasja në dokumente publike

Gjatë vitit 2023, Trafikut Urban i janë adresuar gjashtë kërkesa për qasje në dokumente publike, të cilat janë aprovuar plotësisht.

Njësia e kontrollës së brendëshme

Gjatë vitit 2023, kemi vazhduar të ofrojmë shërbime me një orar të rregullt, nga ora 06:00 deri në 24:00. Autobusët dhe stafi i shërbimeve janë monitoruar rregullisht, duke garantuar një standard të lartë të higjienës dhe shërbimit.

Në përgjithësi, shërbimi ynë ka funksionuar me sukses, megjithatë, ka disa sfida që janë adresuar me sukses dhe janë vlerësuar për përmirësim. Në veçanti, kemi zbatuar ndryshime pozitive si rezultat i vëzhgimeve dhe rekomandimeve:

1. Kemi identifikuar probleme me saktësinë e kohës tek disa arka fiskale dhe me raportime dhe kërkesa janë evituar problemet.
2. Arkat fiskale, edhe pse kishin disa dëme, janë tashmë nën proces riparimi, ndërsa janë parandaluar impaktet negative në shërbimin tonë.
3. Kontrollorët tanë kanë pasuar një qëndrim proaktiv duke konfiskuar bileta mujore me afat të skaduar apo të falsifikuar, duke rritur efikasitetin e shërbimit.

4. Duke pasuar një qasje progresive, kemi njoftuar nxënësit e shkollës së mesme rreth rregullave të pagesës së biletave dhe dokumentimit të statusit të tyre. Mungesa e kartelave të identifikimit të nxënësve të shkollave fillore është një sfidë e madhe për stafin tonë. Jemi të vetëdijshëm që nga drejtuesit tanë është adresuar kjo çështje tek Komuna dhe drejtoritë përkatëse me kërkesë që së paku nxënësit e shkollave fillore të pajisen me kartelë identifikimi. .
5. Edhe pse ka pasuar vonesa të shkaktuara nga trafiku i ngarkuar në qytet, stafi i Trafikut Urban ka menaxhuar situatën dhe ka siguruar që shërbimi të mbetet cilësor dhe me standarte të larta.

Këto hapa pozitiv tregojnë angazhimin tonë për përmirësimin dhe ofrimin e një shërbimi cilësor.

IV. SEKRETARI

Takimet e Bordit të Drejtorëve

Si zyrtar i lartë i emëruar nga Bordi i Drejtorëve kam marrë pjesë në të gjitha takimet e Bordit dhe Komisionit të Auditimit, duke ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme sipas ligjit dhe duke dhënë këshilla ligjore sa herë që më është kërkuar, konform Ligjit për Ndërmarrjet Publike si dhe Rregullores së Punës së Bordit dhe Komisionit të Auditimit, akteve dhe ligjeve të tjera në fuqi.

	Të rregullta	Konstituive	Gjithsej
Mbledhje të Bordit të Drejtorëve	13	x	13
Mbledhje të Komisionit të Auditimit	13	x	13

Aktet e Brendshme të miratuara gjatë periudhës raportuese

Nr.	Akti	Data
1	Statuti	05.04.2023
2	Rregullore për përdorimin e automjeteve zyrtare	01.06.2023
3	Plotësim Ndryshim i Rregullores për Paga dhe Kompensime të tjera	03.07.2023
4	Rregullore mbi përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe Niveli i Kompensimit të Dëmeve	15.11.2023

V. DREJTORIA E PROKURIMIT

Drejtoria e Prokurimit duke ushtruar funksionin e saj ligjor ka siguruar që të gjitha procedurat e prokurimit të zhvillohen në harmoni me ligjet në fuqi. Po ashtu bashkëpunon me personat përgjegjës të njësive organizative të Ndërmarrjes lidhur me hartimin e planit të prokurimit, kërkesave për prokurim, çështjeve financiare, çështjeve të logjistikës dhe çështjeve tjera nga fushveprimtaria e drejtorisë.

Në vitin 2023 janë zhvilluar aktivitetet e prokurimit të planifikuara nga Trafiku Urban, sipas Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimi Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092. Në këtë vit janë zhvilluar 28 aktivitete te prokurimit dhe janë nënshkruar 23 kontrata në vlerë 7,682,107.45 €.

Kontratat/transaksionet 2023

Në shtojcën nr. 2 i gjeni detajet e nevojshme për të gjitha procedurat e prokurimit.

VI. DREJTORIA E FINANCAVE

Performanca financiare e N.P.K “Trafiku Urban” sh.a për periudhën 2019-2023


Pasqyra e performancës financiare për periudhën pesë vjeçare ka për qëllim informimin e palëve të interesuara të brendshme dhe të jashtme. Performanca e ndërmarrjes do të paraqitet përmes zërave kryesorë të pasqyrës së pozitës financiare dhe pasqyrës së performancës financiare: pasuritë, detyrimet, ekuiteti, të hyrat si dhe fitimi/humbja neto në mënyrë tabelore për pesë vitet 2019-2023.

Nr	Përshkrimi	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
1	Asetet	13,339,590	12,796,583	12,108,352	10,612,337	10,493,535
2	Detyrimet	10,209,884	9,368,608	7,888,591	6,486,153	5,581,957
3	Kapitali/Ekuiteti	3,129,706	3,427,978	4,219,762	4,126,185	4,911,578
4	Totali i të Hyrave	6,138,988	5,998,945	7,285,564	7,626,573	9,061,977
5	Fitimi/ Humbja Neto	902,236	494,403	791,784	233,398	968,503

Tabela 1. Treguesit e performancës financiare 2019-2023 NPK Trafiku Urban SHA

Tabela numër 1 na tregon performancën financiare të viteve 2019-2023. Raporti i i performancës është në rritje te treguesi i të hyrave operative, të cilat kanë trend rritës për vitin 2023.

Të njëjtën po e paraqesim më poshtë edhe në mënyrë grafike.



Grafiku 1. Treguesit e performancës financiare 2019-2023 NPK Trafiku Urban SHA

Nr	Përshkrimi	Raporti i rritjes 2020/2019	Raporti i rritjes 2021/2020	Raporti i rritjes 2022/2021	Raporti i rritjes 2023/2022
1	Asetet	-4.07%	-5.38%	-12.33%	-0.91%
2	Detyrimet	-8.24%	-15.80%	-16.07%	-16.53%
3	Kapitali/Ekuiteti	9.53%	23.1	-5.37%	23.64%
4	Totali i të Hyrave	-2.28%	21.45	4.68%	23.61%
5	Fitimi/Humbja Neto	-45.20%	60.15	-71.39%	310.26%

Tabela 2. Raportet e performancës financiare 2019-2023 NPK Trafiku Urban SHA


Tabela numër 2 na tregon raportin e rritjes prej vitit në vit të shprehur në përqindje dhe shohim një rënie të lehtë tek asetet për shkak të amortizimit të aseteve dhe nga kjo tabelë kuptojmë se ndërmarrja nuk ka investuar deri më 2023. Tabela na tregon se kemi rënie të detyrimeve prej vitit në vit, e cila e pasqyron kredinë afatgjate që ndërmarrja e ka të nënshkruar për blerjen e 51 autobusëve. Ngritje të ekuitetit nga rritja e fitimeve të mbajtura. Në vitin 2023 shohim të hyra më të larta prej 23.61% kur e krahasojmë me vitin 2022. Fitimi Neto prej 310.26% më i lartë nëse e krahasojmë me vitin paraprak.

Në vazhdim, më poshtë do të i paraqesim në mënyrë grafike secilin zë financiar me të cilët kemi matur performancën financiare




Grafiku 2. Totali i pasurive dhe trendi lëvizës 2018/2022 NPK Trafiku Urban SHA

Grafiku numër 2. tregon lëvizjen grafike të pasurisë së ndërmarrjes dhe shohim investimin që ka filluar në vitin 2017 dhe 2018, blerja e 51 autobusëve, dhe në vazhdimësi zhvlerësimin e këtyre aseteve, apo rënien e vlerës, sipas normës së rregulluar me politikat e ndërmarrjes prej 8.33%.



Grafiku 3. Totali i detyrimeve dhe trendi lëvizës 2018/2022 NPK Trafiku Urban SHA

Grafiku numër 3 tregon lëvizjen grafike të total detyrimeve dhe shohim një performancë mjaft të mirë të këtij treguesi dhe konkludojmë se detyrimet kanë trend rënës.




Grafiku 4. Totali i Kapitalit/Ekuitetit dhe trendi lëvizës 2018/2022 NPK Trafiku Urban SHA

Grafiku numër 4. tregon lëvizjen grafike të total kapitalit/ekuitetit të viteve 2019/2023. Efekti neto i pasurive dhe detyrimeve tregohet nga ekuiteti, i cili performancën më të mirë e ka arritur në vitin 2023 dhe tregon një rënie të lehtë në vitin 2022.



Grafiku 5. Totali i të hyrave dhe trendi lëvizës 2019/2023 NPK Trafiku Urban SHA

Grafiku numër 5. tregon lëvizjen grafike të total të hyrave për vitet 2019/2023 dhe shohim një trend rritës të këtij treguesi.



Grafiku 6. Totali i fitimit/humbjes neto dhe trendi lëvizës 2019/2023 NPK Trafiku Urban SHA

Grafiku numër 6. tregon lëvizjen grafike të total fitimit/humbjes neto dhe trendit linear të kësaj lëvizjeje për vitet 2019/2023.

Ndërmarrja përkundër shumë sfidave të cilat na kanë përcjellur sidomos rritjes së çmimit të naftës në vitin 2022 dhe si pasojë e kësaj devijim në planifikim për shkak të faktorëve të jashtëm global, e që ka reflektuar edhe në vitin 2023, vazhdon të ofroj shërbime cilësore për qytetarët e Prishtinës duke reflektuar në rritjen e të hyrave neto si dhe menaxhimin sa më efikas të shpenzimeve deri në pikën ku nuk e pengon procesin e punës dhe në vitin 2023 rezulton me një fitim neto prej 968,503.00 euro.

VII. DREJTORIA E ADMINISTRATËS

Përgjegjësitë e Drejtorisë së Administratës janë thelbësore për të siguruar funksionimin normal të Ndërmarrjes, duke mbështetur qëllimet dhe objektivat e saj të përgjithshme.

Kjo drejtori menaxhon dhe koordinon aktivitetet administrative në ndërmarrje. Mbikëqyrë dhe koordinon punën e Zyrës Ligjore, Burimeve Njerëzore, Sigurimin, Teknologjinë e Informacionit, dhe Marketingun.

Zyra Ligjore

Zyra ligjore ka dhënë këshilla sipas kërkesave, ka bërë analiza dhe hulumtime ligjore për nevoja të ndërmarrjes, ka organizuar dhe mbajtur takime me palë të treta dhe institucione, në lidhje me ankesat, kërkesat dhe paqartësitë e tyre të cilat bien në kompetencë të Zyrës Ligjore, sikur që ka hartuar shkresa, akte e vendime për Ndërmarrjen dhe stafin.

Në këtë raport vjetor për vitin 2023 janë të përfshira: Aktet e brendshme të Ndërmarrjes, kontratat, organizimi i Zyrës Ligjore dhe Burimeve Njerëzore, struktura organizative e ndërmarrjes, procedurat gjyqësore etj.

Aktet e brendshme të ndërmarrjes

Numri total i akteve të brendshme të ndërmarrjes si dhe datat e miratimit:

Nr.	Akti	Data
1/2023	Statuti	05.04.2023
2/2023	Rregullore për pëdorimin e automjeteve zyrtare	01.06.2023
3/2023	Plotësim Ndryshim i Rregullores për Paga dhe Kompensime të tjera	03.07.2023
4/2023	Rregullore mbi përcaktimin e kritereve, procedurave dhe Niveli i Kompensimit të Dëmeve	15.11.2023
1/2022	Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës	13.07.2022
2/2022	Rregullore e Punës së Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit	26.08.2022
3/2022	Rregullore për Paga dhe Kompensime të tjera	26.08.2022
1/2020	Procedura për Menaxhimin e Çelësave	26.05.2020
1/2019	Rregullore për Financa dhe Kontabilitet	25.02.2019
2/2019	Rregullore për Orarin e Punës	19.03.2019
3/2019	Vlerësimi i Rrezikshmërisë për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera	14.10.2019
4/2019	Plani i Reagimit Emergjent për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera	14.10.2019

5/2019	Plani për Menaxhimin e Mbeturinave	27.11.2019
6/2019	Plani për Menaxhimin e Vajrave dhe Derivateve	27.11.2019
7/2019	Rregullore për Menaxhimin e Stokut	27.11.2019
8/2019	Menaxhimi i Baterive (akumulatorëve) të Përdorura	27.11.2019
9/2019	Menaxhimi i Gomave të Përdorura	27.11.2019
10/2019	Politika e Sigurisë, Shëndetit, Aspekti Social dhe Kujdesi ndaj Mjedisit	27.11.2019
1/2018	Rregullore mbi Përgjegjësinë Disiplinore dhe Materiale	22.02.2018
2/2018	Kodi i Sjelljes dhe Etikës	22.02.2018
3/2018	Rregullore për Arkivin dhe Lëndën Arkivore	31.05.2018
4/2018	Rregullore për mbajtjen e Dosjeve Personale të Punëtorëve	31.05.2018
1/2017	Rregullore e Marrëdhënies së Punës/ Politika-Procedurat e Personelit	21.08.2017

Marrëveshjet dhe kontratat

Më poshtë janë paraqitur kontratat/marrëveshjet që NPK “Trafiku Urban” SHA ka lidhur me palët e treta gjatë vitit 2023:

Nr.	Pala	Përshkrimi
1	Aeroporti “Adem Jashari”	Marrëveshje me aeroportin nr.1480 dt. 04.05.2023 .
2	Kompania e Sigurimeve”ELSIG”	Kontratë për sigurime shëndetësor nr.1602 dt.17.05.2023
3	Telekomi i Kosovës SHA”VALA”	Marrëveshje nr.3419 dt. 13.09.2023 për ofrimin e shërbimeve.
4	IPKO Telecommunications sh.p.k	Marrëveshje nr.3421 dt.13.09.2021 për ofrimin e shërbimeve.
5	Komuna e Prishtinës	Aneks Kontratë Publike për shërbimet e transportit publik nr.3565 dt.26.09.2023
5	Gjirafa INC	Marrëveshje nr.4848 dt. 21.12.2023 për ofrimin e shërbimeve për shfrytëzim të Autobusit
6	Kuzhina Qendrore	Kontratë për furnizim me shujta ushqimore nr.3685 e dt.02.10.2023

Proceset gjyqësore

NPK "Trafiku Urban" SHA gjatë vitit 2023 ka zhvilluar këto procedura gjyqësore.

Aktgjykime dhe aktvendime

Nr.	Nr. i lëndës	Lloji i lëndës	Vlera	Data
1	C.nr.3159/20	Civile	/	23.01.2023
2	C.nr.4397/19	Civile	/	19.06.2023
3	Ac.nr.10090/21	Civile	1,818.25 euro	01.08.2023
4	Rev.nr/364/23	Civile	3742.80 euro	24.11.2023
5	Ac.nr.233/20	Civile	36,194.00 euro	12.12.2023
6	C.nr.6878/23	Civile	/	27.12.2023
7	C.nr.199/20	Civile	1,600.00 euro	27.10.2023
9	Ac.nr.1785/20	Civile	/	26.01.2023
10	Ac.nr.4625/19	Civile	8,297.89 euro	01.03.2023

Tabelari i lëndëve gjyqësore për të cilat janë ndërmarrë veprime gjatë vitit 2023

Nr	Nr. lëndës	Lloji i lëndës	Vlera e kontestit	Procesi i lëndës
1	C.nr. 4035/20	Civile	/	Gj. Themelore
2	C.nr.3159/20	Civile	300.00euro	Gj.Themelore
3	C.nr.6878/23	Civile	/	Gj.Themelore
4	C.nr.1306/20	Civile	2,307.00 euro	Gj.Themlelore
5	C.nr.1316/20	Civile	808.00 euro	Gj.Themlelore
6	C.nr.4397/19	Civile	/	Gj.Themlelore

7	C.nr.3374/23	Civile	/	Gj.Themelore
8	C.nr.4081/22	Civile	/	Gj.Themelore
9	C.nr.199/20	Civile	/	Gj.Themelore
10	C.nr.2272/21	Civile	/	Gj.Themelore

Lëndët gjyqësore të përfunduara gjatë periudhë raportuese

Nr.	Nr.i lendes	Lloji i lendes	Vlera e pergjithshme	Kamata (€)	SH.Procedures	Pagesa	Gjithsej
1	PPP.nr.1076/18	Përmbarrimor e	x	x	x	x	x
2	C.nr.2771/14	Civile	6,308.00 euro	680.67	699.00 euro	8,297.89	8,297.89
3	C.nr.3694/18	Civile	x	x	x	x	x
4	C.nr.2404/17	Civile	1,564.73 euro	8%	269 euro	1,818.25 euro	1,818.25 euro
5	C.nr.192/15	Civile	36,431.00 euro	3,000.12 euro	800.75 euro	40,231.87 euro	40,231.87 euro

Totali i lëndëve gjyqësore të cilat janë aktive

Nr.	Nr.i lëndës	Lloji i lëndës	Vlera e kontestit	Procesi i lëndës
1	K.nr.5582/17	Kundervajtje	600.00 euro	Gj.Apelit
2	C.1724/19	Civil	8,610.35euro	Gjykat Apelit
3	Cp.nr.2349/19	Përmbarrimore		Gjykat Apelit
4	C.nr.3683/19	Civil	8,010.00 euro	Gjykatë Themelore
5	C. nr. 3159/20	Civile	1.030.73euro	Gj.Themelore
6	C.nr.1207/21	Caktim I Masës së Sigurisë	x	Gj.Themelore
7	C.nr.1908/18	Civile	x	Gj.Themelore
8	C.nr.2272/21	Civile	x	Gj.Themelore
9	C.nr.4035/2022	Civile	x	Gj.Themelore

10	C.nr.4081/2022	Civile	x	Gj.Themelore
11	P.nr.145/18, PPP.nr.111/2018	Përmbarimore	10.649.84euro	Gj. Themelore
12	Padia nr.57 e dates 23.01.2018	Civile	5.956.99euro	Gj.Themelore
13	2020-AD-3583 (Denoncim në Polici)	Penale	525,28.00 €	Polici
14	C.nr.1715/18	Civile	x	Gj.Themelore
15		Civile	1358.89	Gj.Themelore
16	C.nr.4397/19	Civile	x	Gj.Themelore
17	C.nr.3374/23	Civile	x	Gj.Themelore
18	C.nr.1316/20	Civile	808.00euro	Gj.Themelore
19	C.nr.199/20	Civile	x	Gj.Themelore
20	C.nr.6878/23	Civile	x	Gj.Themelore

Përpunimi i shkresave administrative gjatë tremujorit të katërt

Vendime për pushim vjetor	816
Aktvendime për paaftësi të përkohshme	342
Vendime me rastin e vdekjes	4
Vendime me rastin e lindjes së fëmijës	10
Vendime për pushim të lehonisë	3
Pushim pa pagesë	2
Kërkesa	1831
Kontrata	286
Përgjigje	33
Marrëveshje	110
Ankesa	18
Mandat pagesë	329
Fletëparaqitje	53
Vërejtje	98
Vertetime	33

Raporte	116
Procesverbale	37
Fatura	389
Vendime Tjera	412
Tjera	28
Gjithsej	4950

Zyra e Burimeve Njerëzore

Burimet Njerëzore janë aseti më i rëndësishëm dhe kanë rolin kyç në çdo Ndërmarrje të vogël, të mesme ose të madhe. Fati i ndërmarrjes është në duart e njerëzve dhe efikasitetin e Burimeve Njerëzore. Zhvillimi i ndërmarrjes dhe i burimeve njerëzore janë të ndërlidhura në mes veti dhe qëllimet brenda ndërmarrjes mund të realizohen nëse në radhët e veta ka një strukturë të fortë stabile të Burimeve Njerëzore.

Burimet Njerëzore janë të përfshira në procesin e planifikimit, organizimit të personelit, udhëheqjes dhe kontrollit. Gjatë vitit 2023 kanë qenë 16 raste aktive në inspektoratin e punës, janë hapur 64 konkurse për pozita të ndryshme të punës sipas Organogramit të cilat janë elaboruar në tabelën e mëposhtme lidhur me mbarëvajtjen e procesit të rekrutimit për këto pozita, janë angazhuar 6 punëtorë për punë praktike për shkak të volumit të madhe të punës nëpër sektor të ndryshëm: Praktikante /Zyrtare e Burimeve Njerëzore, Praktikante/Zyrtare Ligjore, Praktikante/Arkatare, Praktikante/Zyrtare për shqyrtim të ankesave, 2 Praktikant/Kontrollor i komunikacionit, janë lidhur 43 kontrata të punës në Ndërmarrje.

Gjatë vitit 2023 janë lidhur 43 kontrata të punës, 1 punëtor me pozitën e punës “Zyrtar i Burimeve Njerëzore”, 1 punëtor me pozitën e punës “Kryeshf Ekzekutiv”, 2 punëtor me pozitën e punës “Kontrollor i Komunikacionit”, 1 punëtor me pozitën e punës ”Punëtor Sigurimi”, 1 punëtor me pozitën e punës “Shef i ndërrimit”, 1 punëtor me pozitën e punës “Depoist Ndërrimi”, 2 punëtorë me pozitën e punës “Gomister”, 6 punëtorë me pozitën e punës “Mekanik”, 5 punëtorë me pozitën e punës “Pastrues të Autobusëve”, 1 punëtor me pozitën e punës “Shofer i KE”, 1 punëtor me pozitën e punës “Mbushës i Fluideve dhe derivateve”, 1 punëtor me pozitën e punës “Auditore e Brendshme”, 1 punëtor me pozitën e punës “Drejtor i Administratës”, 15 punëtorë me pozitën e punës “Kondukter” dhe 1 punëtorë me pozitë pune “Zyrtar për evidence te inventarit, janë bërë 21 lëvizje të punëtoreve në pozita të ndryshme brenda ndërmarrjes për shkak të plotësimit të vendeve dhe avancimit të punëtoreve, 10 punëtorë kanë kaluar në pensionim të rregullt dhe janë shkëputur 21 marrëdhënie pune në mënyrë vullnetare, si dhe një shkëptje ka ardh si pasojë e vdekjes së punëtorit.

Të gjitha këto të dhëna i gjeni në tabelat e mëposhtme:

Inspektorati i Punës

Nr	Lënda	Pranuar nga IP	Vendimi	Organi	Vepri mi	Data	Epilogu
1	Nr.175/2021	Vendim	Refuzohet	IP	/	07.02.2023	/
2	Nr.09-183-824/2022	Raport Zyrtar	Refuzohet	IP	/	16.02.2023	/
3	Nr.693/2022	Raport Zyrtar	Refuzohet	IP	/	16.02.2023	/
4	Nr.48-05/B/2023	Raport zyrtar	Aprovohet	IP	/	06.03.2023	/
5	Nr.01/56-95/2023	Raport Zyrtar	Refuzohet	IP	/	16.03.2023	/
6	Nr.883	Ankesë	x	IP – shkallës e dytë	/	14.03.2023	/
7	01.Nr.25-140/2023		E pabazuar	IP	x	18.07.2023	x
8	01.Nr.25-140/2023		E pabazuar	IP	x	18.07.2023	x
9	Nr.01/25-08/22-A dhe Nr.25-13/2022		Shfuqizim	IP	x	18.07.2023	x
10	Nr.01/08-153/2023		x	IP	x	29.08.2023	E pabazuar
11	Nr.01/08-182/2022-A	Raport zyrtar Rinspektues	x	IP	Ankesë	30.10.2023	x
12	RZ01Nr.25-219/2023	Raport zyrtar	x	IP	Ankesë	08.11.2023	x
13	RZ01Nr.25-219/2023	Raport zyrtar	x	IP	Ankesë	08.11.2023	x
14	01.Nr.48-91-1/2023	Raport zyrtar	Aprovohet	IP	Ankesë	21.12.2023	x
15	Nr.01/56-342/2023	Raport zyrtar	Refuzohet	IP	Ankesë	21.12.2023	x
16	01.Nr.13/145	Vendim	Refuzohet	IP	Ankesë	22.12.2023	x

Konkurset e punës të hapura nga TU gjatë periudhës raportuese

Nr.	Emertimi	Nr.Pozitave	Lloji	Data e konkursit	Koment
1	Konkurs për praktikant	6	Konkurs i jashtëm	04.01.2023	I perfunduar
2	Konkurs për Kondukter	2	<u>Konkurs i Brendshëm</u>	24.01.2023	I perfunduar
3	Konkurs Zyrtar Certifikues	1	<u>Konkurs i Brendshëm</u>	24.01.2023	I perfunduar
4	Konkurs Drejtor i Administratës	1	<u>Konkurs i Brendshëm</u>	24.01.2023	Anuluar
5	Konkurs Punëtor Sigurimi	1	<u>Konkurs i jashtëm</u>	25.01.2023	I perfunduar
6	Konkurs Gomister	2	<u>Konkurs i jashtëm</u>	25.01.2023	I përfunduar
7	Konkurs Elektricitist	1	<u>Konkurs i jashtëm</u>	25.01.2023	Përsëritje
8	Konkurs Mekanik	4	<u>Konkurs i jashtëm</u>	25.01.2023	Përsëritje
9	Konkurs Kontrollor Komunikacioni	2	<u>Konkurs i jashtëm</u>	25.01.2023	Përsëritje
10	Konkurs Riparues Karroserie	1	<u>Konkurs i jashtëm</u>	25.01.2023	Përsëritje
11	Konkurs Depoist Ndërrimi	1	<u>Konkurs i jashtëm</u>	25.01.2023	Përsëritje
12	Konkurs Mbushës i Derivateve	1	<u>Konkurs i jashtëm</u>	25.01.2023	Përsëritje
13	Konkurs ZAB	1	<u>Konkurs i jashtëm</u>	30.01.2023	Anulohet
14	Konkurs për KE	1	<u>Konkurs i jashtëm</u>	31.01.2023	I përfunduar
15	Konkurs për Mekanik	1	<u>Konkurs i jashtëm</u>	03.03.2023	I përfunduar
16	Konkurs Riparues Karroserie	1	<u>Konkurs i jashtëm</u>	03.03.2023	I përfunduar
17	Konkurs per Elektricitist	1	<u>Konkurs i jashtëm</u>	03.03.2023	I përfunduar
18	Konkurs Zyrtar për Marketing	1	<u>Konkurs i jashtëm</u>	03.03.2023	I përfunduar
19	Konkurs Zyrtar për Protokoll	1	<u>Konkurs i jashtëm</u>	03.03.2023	I përfunduar

20	Konkurs Udhëheqës i Zyrës Ligjore	1	<u>Konkurs i jashtëm</u>	03.03.2023	I përfunduar
21	Konkurs Receptionist	1	<u>Konkurs i jashtëm</u>	03.03.2023	I përfunduar
22	Konkurs – Pastrues Autobusi	5	Konkurs i jashtëm	12.06.2023	I përfunduar
23	Konkurs - Elektricitist	1	<u>Konkurs i Brendshëm</u>	12.06.2023	I përfunduar
24	Konkurs - Kondukter	2	<u>Konkurs i Brendshëm</u>	12.06.2023	I përfunduar
25	Konkurs - Kontrollor	1	<u>Konkurs i Brendshëm</u>	12.06.2023	I përfunduar
26	Konkurs - Shofer	6	<u>Konkurs i Brendshëm</u>	12.06.2023	I përfunduar
27	Kondukter	15	Konkurs i jashtëm	10.07.2023	Anulohet
28	Depoist Ndërrimi	1	Konkurs i brendshëm	10.07.2023	I përfunduar
29	Shofer	5	Konkurs i brendshëm	10.07.2023	I përfunduar
30	Kontrollor teknik	2	Konkurs i brendshëm	10.07.2023	I përfunduar
31	Shofer i KE	1	Konkurs i jashtëm	10.07.2023	Anulohet
32	Mekanik	6	Konkurs i jashtëm	10.07.2023	I përfunduar
33	Kondukter	15	Konkurs i jashtëm	10.07.2023	Anulohet
34	Elektricitist	3	Konkurs i jashtëm	13.07.2023	Anulohet
35	Zyrtar për trajnime	1	Konkurs i jashtëm	15.08.2023	Anulohet
36	Elektricitist	3	Konkurs i jashtëm	15.08.2023	Anulohet
37	Riparues Karroserie dhe Autongjyroses	1	Konkurs i jashtëm	15.08.2023	Anulohet
38	Shofer i Kryeshefit Ekzekutiv	1	Konkurs i jashtëm	15.08.2023	I përfunduar
39	Mbushës i Derivateve dhe fluideve	1	Konkurs i jashtëm	15.08.2023	I përfunduar
40	Zyrtar për trajnime	1	Konkurs i jashtëm	15.08.2023	Anulohet

41	Punëtor Sigurimi	1	Konkurs i Brendshëm	14.09.2023	Anulohet
42	Shites i biletave mujore	1	Konkurs i brendshem	14.09.2023	I përfunduar
43	Udheheqes i Burimeve njerezore	1	Konkurs i brendshem	14.09.2023	I përfunduar
44	Zyrtar financiar	1	Konkurs i brendshem	14.09.2023	I përfunduar
45	Zyrtar Ligjor	1	Konkurs i brendshem	14.09.2023	Anulohet
46	Shef Nderrimi	1	Konkurs i brendshem	14.09.2023	I përfunduar
47	Auditor i brendshem	1	Konkurs i jashtem	14.09.2023	Anulohet
48	Drejtor i Administratës	1	Konkurs i jashtëm	14.09.2023	Anulohet
49	Kondukter	15	Konkurs i jashtem	14.09.2023	I përfunduar
50	Elektracist	3	Konkurs i jashtem	28.09.2023	Anulohet
51	Zyrtar per evdidence te inventarit	1	Konkurs i jashtem	28.09.2023	Anulohet
52	Zyrtar per trajnime	1	Konkurs i jashtem	28.09.2023	Anulohet
53	Drejtor i Administratës	1	Konkurs i jashtëm	16.10.2023	I Përfunduar
54	Monitorues i kamerave te sigurisë se Objektit	3	Konkurs i jashtëm	26.10.2023	I Përfunduar
57	Monitorues i kamerave dhe paneleve informuese	1	Konkurs i jashtëm	26.10.2023	Anuluar
58	Punëtor Sigurimi	1	Konkurs i jashtëm	26.10.2023	Anuluar
59	Zyrtar per evidencë të Inventarit	1	Konkurs i jashtëm	26.10.2023	I Përfunduar
60	Zyrtar për arka fiskale	1	Konkurs i jashtëm	26.10.2023	Anuluar
61	Zyrtar për protokoll	1	Konkurs i jashtëm	19.12.2023	I Përfunduar
62	Zyrtar Ligjor	1	Konkurs i jashtëm	19.12.2023	I Përfunduar
63	Punëtor Sigurimi	1	Konkurs i jashtëm	19.12.2023	Anuluar
64	Zyrtar për arkivë qendrore	1	Konkurs i jashtëm	19.12.2023	I Përfunduar

Angazhimi i punëtorëve për punë praktike

1	Praktikante /Zyrtare e Burimeve Njerezore	06.02.2023	Me konkurs
2	Praktikante/Zyrtare Ligjore	23.01.2023	Me konkurs
3	Praktikante/Arkatare	30.01.2023	Me konkurs
4	Praktikante/Zyrtare per shqyrtim te ankesave	23.01.2023	Me konkurs
5	Praktikant/Kontrollor i komunikacionit	23.01.2023	Me konkurs
6	Praktikant/Kontrollor i komunikacionit	23.01.2023	Me konkurs

Krijimi i marrëdhënies së punës në Ndërmarrje

1	Zyrtar i Burimeve Njerëzore	20.03.2023	Me vendim të gjykatës
2	Kryeshef Ekzekutiv	03.04.2023	Me konkurs
3	Kontrollor i Komunikacionit	03.04.2023	Me konkurs
4	Kontrollor i Komunikacionit	03.04.2023	Me konkurs
5	Punëtor Sigurimi	03.04.2023	Me konkurs
6	Shef i ndërrimit	03.04.2023	Me konkurs
7	Depoist Ndërrimi	03.04.2023	Me konkurs
8	Gomister	03.04.2023	Me konkurs
9	Gomister	03.04.2023	Me konkurs
10	Zyrtare për Marketing	15.05.2023	Me konkurs
11	Receptioniste	15.05.2023	Me konkurs
12	Zyrtare për protokoll	15.05.2023	Me konkurs
13	Mekanik	12.06.2023	Me konkurs
14	Mekanik	12.06.2023	Me konkurs
15	Mekanik	12.06.2023	Me konkurs
16	Pastrues Autobusi	01.08.2023	Me konkurs
17	Pastrues Autobusi	01.08.2023	Me konkurs
18	Pastrues Autobusi	01.08.2023	Me konkurs
19	Pastrues Autobusi	01.08.2023	Me konkurs
20	Pastrues Autobusi	01.08.2023	Me konkurs
21	Mekanik	01.09.2023	Me konkurs
22	Mekanik	01.09.2023	Me konkurs
23	Mekanik	01.09.2023	Me konkurs

24	Shofer i KE	16.10.2023	Me konkurs
25	Mbushës i Fluideve dhe derivateve	16.10.2023	Me konkurs
26	Auditore e Brendshme	13.11.2023	Me konkurs
27	Drejtor i Administrates	20.11.2023	Me konkurs
28	Kondukter	20.12.2023	Me konkurs
29	Kondukter	20.12.2023	Me konkurs
30	Kondukter	20.12.2023	Me konkurs
31	Kondukter	20.12.2023	Me konkurs
32	Kondukter	20.12.2023	Me konkurs
33	Kondukter	20.12.2023	Me konkurs
34	Kondukter	20.12.2023	Me konkurs
35	Kondukter	20.12.2023	Me konkurs
36	Kondukter	20.12.2023	Me konkurs
37	Kondukter	20.12.2023	Me konkurs
38	Kondukter	20.12.2023	Me konkurs
39	Kondukter	20.12.2023	Me konkurs
40	Kondukter	20.12.2023	Me konkurs
41	Kondukter	20.12.2023	Me konkurs
42	Kondukter	20.12.2023	Me konkurs
43	Zyrtar për evidence te inventarit	26.12.2023	Me konkurs

Lëvizjet e punëtoreve në pozita të ndryshme brenda ndërmarrjes

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Pozita e mëparshme	Lloji i kontratës	Pozita e aktuale	Arsyeja	Data e ndryshimit të pozitës
1	A. K	Zyrtar për Evidencë	Kohë të Caktuar	Zyrtarë për Çertifikim	Me konkurs	15.03.2023
2	M.B	Pastruese e Autobusëve	Kohë të Caktuar	Konduktore	Me konkurs	13.03.2023
